


**SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË
SH.A**

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

së bashku me

Raportin e Audituesve të Pavarur



Përmbajtja

Përmbajtja.....	1
Raporti i Audituesve të Pavarur.....	2
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	6
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto.....	8
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare.....	9
Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare.....	10
1. Njesia raportuese.....	10
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare.....	11
2.a. Deklarata e pajtueshmërisë.....	11
2.b. Baza e matjeve.....	11
2.c. Biznesi në vijimësi.....	11
2.d. Monedha raportuese.....	11
2.e. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	11
3. Burimet për vlerësimin e pasigurisë.....	12
3.a. Provizione.....	12
3.b. Vlerësimi i rrezikut të kredisë.....	12
3.c. Matja e vlerës së drejtë.....	12
4. Përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabel.....	13
4.a. Transaksionet në monedhë të huaj.....	13
4.b. Instrumentet Financiare.....	13
4.c. Inventari.....	16
4.d. Aktivet afatgjata materiale.....	17
4.e. Aktivet afatgjata jomateriale.....	18
4.f. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare.....	19
4.g. Aktive investuese.....	19
4.h. Provizionet.....	20
4.i. Njohja e të ardhurave.....	20
4.j. Tatimi mbi fitimin.....	21
4.k. Fondet për pensione.....	21
4.l. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara.....	21
4.m. Transaksionet me palët e lidhura.....	21

4.n. Krahueshmëria e informacionit kontabel.....	22
4.o. Zbatimi i standardeve të rinj dhe të rishikuar.....	22
5. Raportimi për herë të parë sipas SNRF-ve.....	23
5.a. Rakordimi i pozicionit financiar në datën e kalimit sipas SNRF-ve.....	24
5.b. Rakordimi i flukseve monetare në datën e fundit të raportuar sipas SKK-ve.....	27
6. Aktivet afatgjata materiale.....	29
7. Aktivet afatgjata jomateriale.....	30
8. Aktivet afatgjata financiare.....	30
9. Inventarët.....	31
10. Kapital i nënshkruar i papaguar.....	31
11. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme.....	32
12. Mjete monetare.....	33
13. Kapitali i nënshkruar.....	33
14. Fitimi (Humbja) e pashpërndarë.....	33
15. Të ardhura të shtyra.....	34
16. Të tjera kontribute.....	34
17. Provizione.....	34
18. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë.....	35
19. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme.....	36
20. Të ardhura nga veprimtaria kryesore.....	36
21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme.....	37
22. Shpenzime të personelit.....	37
23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi.....	37
24. Shpenzime të tjera shfrytëzimi.....	38
25. Të ardhura të tjera.....	38
26. Kosto të financimit.....	39
27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	39
28. Transaksionet me palët e lidhura.....	40
29. Manaxhimi i rrezikut financiar.....	41
30. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara.....	43
31. Ngjarje pas datës së raportimit.....	43

Raporti i Audituesve të Pavarur

për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Drejtuar Aksionarëve të njësisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A (Shoqëria/Njësia) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2024, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin "Bazat për Opinionin me Rezervë", pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Njesisë më datën 31 dhjetor 2024, dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Në shënimin 6 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2024, "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerën 8.66 miliard lekë (31 dhjetor 2023: 8.28 miliard lekë dhe 1 janar 2023: 8.3 miliard lekë). Shoqëria ka zgjedhur *modelin e kostos* për të përcaktuar vlerën e aktiveve afatgjata materiale duke i paraqitur me koston historike të pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe humbjet eventuale të krijuara nga zhvlerësimi.

Klasat troje dhe ndërtesa me vlerë 750.64 milion lekë në datën 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 674.81 milion lekë dhe 1 janar 2023: 707.48 milion lekë) nuk janë të mbështetura tërësisht në dokumenta pronësie, duke konfirmuar kështu rrethanat e *pasigurisë së lartë* që bart vetvetëshëm mjedisi ekonomik, lidhur me pronësinë.

Investimi dhe zhvillimi i rrjeteve të reja ujësjellës ka shkaktuar nxjerrjen jashtë funksioni të infrastrukturës së vjetër, e cila nuk ishte amortizuar tërësisht në librat kontabël dhe aktualisht vlera e tyre përfshihet në klasën "Instalime specifike dhe komplekse", e cila në datën 31 dhjetor 2024 paraqitet 7.21 miliard lekë (31 dhjetor 2023: 6.86 miliard lekë dhe më 1 janar 2023: 6.89 miliard lekë). Për më tepër, nga vetë natyra dhe jeta e përdorimit të rrjeteve infrastrukturore, paraqitja e tyre me modelin e koston nuk reflekton ndryshimin e nivelit të çmimeve dhe *vlera kontabël ndryshon materialisht nga vlera e drejtë*. Nga ana tjetër, infrastruktura gjendet nën tokë dhe inventarizimi vjetor i saj kryhet vetëm në aspektin kontabël, ndërsa ligji dhe rregullat kërkojnë që inventarizimi i aktiveve me përmbajtje fizike të bëhet *jo vetëm përmes numërimit* të tyre por dhe duke i krahasuar gjendjet fizike me ato kontabël.

Regjistri analitik i aktiveve afatgjata nuk është i konsoliduar dhe listat e veçanta nuk kanë strukturë të njëjtë, për pasojë informacioni që sigurohet është i pakët, ruajtja dhe mirëadministrimi vështirësohet dhe rreziku për gabime është i lartë.

Si pasojë e çështjeve të përshkruara në këtë paragraf ne nuk arritëm të krijojmë siguri në lidhje me ekzistencën dhe vlerën e aktiveve afatgjata materiale si dhe nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme të kryhen rregullime për aktivet afatgjata më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 si dhe më 1 janar 2023.

2. Në shënimin 18, "Detyrime ndaj institucioneve të kredisë", në pasqyrën e pozicionit financiar, huatë paraqiten për shumën për shumën 5.38 miliard lekë në datën 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 5.38 miliard lekë dhe 1 janar 2023: 5.33 miliard lekë). Këtu përfshihen hua afatgjata në njësi monetare Euro, nga institucione ndërkombëtare, të lëvruara me marrëveshje Nën-Huaje nga Ministria e Financave.

Njësia e ka njohur stokun fillestar të detyrimit në monedhën lekë dhe vijon e paraqet detyrimin financiar pa konsideruar njësinë monetare të mardhënies kontraktuale, ndërsa vlera me të cilën paraqiten detyrimet financiare duhet të matet me një nga metodat që përcakton SNRF 9, "Instrumentet financiarë", bazuar në vegoritë e instrumentit dhe modeli i biznesit, përfshi rrethanat dhe pasiguritë nga e ardhmja, por shoqëria nuk ka paraqitur një politikë të shkruar për këtë qëllim. Për këto arsye, duke theksuar edhe kompleksitetin e përlogaritjeve, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse rregullime për huatë afatgjata dhe shpenzimet e interesit janë të nevojshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 si dhe më 1 janar 2023 nëse do të zbatoheshin kërkesat e SNRF 9.

Raporti i Audituesve të Pavarur

për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

3. Në shënimin II, "Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera", në pasqyrën e pozicionit financiar, përfshihen llogari të arkëtueshme tregtare në vlerën neto 351.69 milion lekë më 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 352.21 milion lekë dhe 1 janar 2023: 345.65 milion lekë). Njësia paraqet zhvlerësim të kërkesave të arkëtueshme për vlerën 51.94 milion lekë në datën 31 dhjetor 2024 (31 dhjetor 2023: 53.78 milion lekë dhe 1 janar 2023: 55.93 milion lekë). SNRF 9, "Instrumentet financiare" kërkon që për matjen e zhvlerësimit të konsiderohet dhe përcaktohet rreziku i mosarkëtimit të kërkesave përgjatë gjithë kohës deri në maturimin e tyre, por njësia nuk ka paraqitur një politikë të shkruar për këtë qëllim. Si pasojë, për shkak edhe të mënyrës së mbajtjes së regjistrimeve, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të shkaktohen në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 si dhe më 1 janar 2023, si rrjedhojë e rregullimeve që mund të jenë të nevojshme të kryhen për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe shitjet për vitet e mbyllura në ato data.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësisë të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEK-së.

Çështjet me rëndësi të auditimit

Çështjet me rëndësi janë ato çështje, të cilat u adresuan gjatë përmbushjes së auditimit të pasqyrave financiare të periudhës 2024 dhe sipas gjykimit profesional të audituesit, ndikuan më së shumti në këtë angazhim dhe në formimin e opinionit mbi pasqyrat financiare në tërësi dhe ky paragraf nuk përbën një opinion të veçantë. Përcaktimi i këtyre çështjeve është rezultat i gjykimit dhe arsytimit dhe mund të lidhen me zona që paraqesin rrezik të lartë për pasaktësi, ose zona komplekse, të cilat përfshijnë një nivel të lartë gjykimi nga drejtuesit e njësive, përfshi vlerësimet kontabël, të cilat mbartin vetvetiu pasiguri, ose zona që paraqesin vështirësi për të siguruar evidencë, apo edhe zona që kërkojnë njohuri të veçanta dhe nevojitet konsultimi i audituesit me ekspertë apo persona të specializuar.

Sistemi i mbajtjes së kontabilitetit

Gjatë kryerjes së procedurave të auditimit ne konstatuam se sistemi i kontabilitetit përbëhet nga dy komponentë të veçuar, ku njëri është përgjegjës për blerjet, inventarët, pagesat monetare dhe veprimet e ndryshme dhe i mban regjistrimet në bartës informatik të autorizuar. Komponenti tjetër është përgjegjës për arkëtimet monetare bankare dhe me para në dorë (arkat), të cilat regjistrohen manualisht në mënyrë kronologjike dhe sistematike në ditarë, si dhe për shitjet, të cilat nuk regjistrohen por shfrytëzohet bartësi informatik i departamentit të shitjeve. Ky bartës nuk i përmbush kërkesat e ligjit 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si për mbajtjen e regjistrimeve ashtu edhe për informacionin që gjeneron.

Mbajtja e një sistem kontabël të fragmentuar ku për më tepër, mbajtja e transaksioneve të shitjes nuk përmbush kërkesat ligjore dhe rregullatore janë arsytet bazë që kjo çështje është paraqitur në këtë seksion të raportit tonë.

Informacione të tjera që kërkohen nga Kuadri Ligjor e Rregullator

Drejtimi ka përgjegjësinë për përgatitjen dhe raportimin e informacioneve të tjera, të cilat parashikohen në Ligjin 25/2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare bashkëngjitur dhe as raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon këto informacione të tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni i cili të japë siguri në lidhje me këto informacione.

Në kuadrin e auditimit të pasqyrave financiare nga ana jonë, ne kemi përgjegjësinë për të lexuar informacionet e tjera, kur ato të na vihen në dispozicion dhe në këtë proces duhet të konsiderojmë nëse informacionet e tjera janë materialisht kontradiktore me paraqitjet në pasqyrat financiare apo njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, apo kanë pasaktësi të tjera materiale. Nëse bazuar në punën që do të kishim kryer mbi informacionet e tjera të siguruar para datës së këtij raporti të audituesit, ne do të arrinim në konkluzionin se ato informacione përmbanin pasaktësi materiale, ne do të ishim të detyruar ta raportonim atë fakt. Siç përshkruhet

Raporti i Audituesve të Pavarur

për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

në paragrafin "Baza për Opinionin me Rezervë" pasqyrat financiare përmbajnë pasaktësi materiale, siç është listuar në atë paragraf. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të sigurohemi nëse edhe informacionet e tjera do të përmbajnë pasaktësi materiale që lidhen me ato çështje.

Përgjegjësitë e Administratorëve dhe të Këshillit Mbikqyrës në lidhje me Pasqyrat Financiare

Administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që *nuk përmbajnë pasaktësi materiale*, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, administratori i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likudojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përmbushjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisëm, përfshi publikimin e pasqyrave financiare dhe informacionit jofinanciar.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një *siguri të arsyeshme* lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë *pasaktësi materiale*, për shkak të *mashtrimit apo gabimit*, dhe të lëshojmë një raport të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një pasaktësi materiale kur ajo ekziston. Pasaktësitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen *materiale* nëse, individualisht ose së bashku, pritët që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne *ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin* tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e pasaktësisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një pasaktësie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e njësisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që njësia të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, u japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe i komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Raporti i Audituesve të Pavarur

për Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Nga gësjtjet e komunikuaa personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato gësjtje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe, për pasojë, edhe gësjtje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto gësjtje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të gësjtjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që gësjtja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritët në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik

17 qershor 2025

Sokol Toska
Auditues Ligjor

Rr. Tish Dahia, Kompleksi Kika 2
Kulla 2, Nr. 33, Tiranë 1060
+355 683317751
L62207031A



Etleva Gani
Auditues Ligjor

Rr. Myslim Shyri, Pallati Nr. 55,
Shkalla 2, Nr. 13, Tiranë
+355 672063065
L2180400IV



Pasqyra e Pozicionit Financiar

me 31 dhjetor 2024

Vlerat janë në mijë lekë, (000 lekë)	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023	1 janar 2023
AKTIVET				
Aktivitet afatgjata materiale	6	8,660,670	8,281,410	8,301,972
Aktivitet afatgjata jo materiale	7	18,420	20,285	20,235
Aktivitet afatgjata financiare	8	168,000	168,000	168,000
Aktivitet Afatgjata		8,847,090	8,469,695	8,490,207
Inventarët	9,6	113,186	109,329	115,518
Kapitali i nënshkruar i papaguar	10,13	4,900	4,900	4,900
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	11,25	389,606	419,558	411,938
Mjetet monetare	12	511,375	368,638	360,092
Aktivitet Afatshkurtra		1,019,067	902,425	892,449
Aktivitet Total		9,866,157	9,372,120	9,382,656
KAPITALI DHE DETYRIMET				
Kapitali i Nënshkruar	13,110	10,000	10,000	10,000
Fitimi (Humbja) e pashpërndarë	14,5.a	(126,665)	(50,257)	0
Fitimi (Humbja) e vitit		9,803	(76,408)	(50,257)
Total fondet e veta dhe kapitali		(106,862)	(116,665)	(40,257)
Të ardhura të shtyra	15,25	3,285,239	2,769,933	2,752,619
Të tjera kontribute	16,5.a	1,114,339	1,114,339	1,114,339
Provizione	17,25	1,890	1,890	2,175
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	18	5,356,856	5,369,640	5,098,181
Detyrimet Afatgjata		9,758,324	9,255,802	8,967,314
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme	19	182,458	221,510	214,100
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	18	32,236	11,472	241,499
Detyrimet Afatshkurtra		214,694	232,982	455,599
Total Detyrimet		9,973,018	9,488,785	9,422,913
Total Detyrimet dhe Kapitali		9,866,157	9,372,120	9,382,656

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëuese, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori i shoqërisë me 31 mars 2025 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Petrit TARE
Administrator



Erida FILIP
Drejtoresh e Drejtorisë Ekonomike

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

		2024	2023
Vlerat janë në mijë lekë. [0000 lekë]			
Shënime			
Të ardhura nga veprimtaria kryesore	20	486,957	467,133
Total të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit		486,957	467,133
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	21	(106,555)	(95,467)
Shpenzime të personelit	22	(205,018)	(214,185)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23.6.7	(155,144)	(162,960)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	24	(53,208)	(67,869)
Total shpenzime të shfrytëzimit		(519,924)	(540,481)
Të ardhura të tjera	25	98,826	55,901
Shpenzime financiare	26	(56,056)	(58,961)
Fitim (Humbja) para tatimit		9,803	(76,408)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	0	0
Fitimi (Humbja) e vitit		9,803	(76,408)
Te ardhura te tjera gjithperفشیرههه per vitin:			
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		0	0
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		0	0
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		9,803	(76,408)

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

Vlerat janë në mijë lekë, [000 lekë]	Shënime	Ndryshime			Totali
		Kapitali i Nënshkruar	Fitimi (Humbja) e pashpërndarë	Fitimi (Humbja) e vitit	
Pozicioni financiar më 1 janar 2023		10,000	0	(50,257)	(40,257)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi/Humbja për periudhën kontabël				(76,408)	(76,408)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		0	0	(76,408)	(76,408)
Transaksionet me aksionarët e njësisë ose të njohura direkt në kapital:					
Emetimi kapitalit					0
Shpërndarje e rezultatit të periudhës			(50,257)	50,257	0
Totali i transaksioneve me aksionarët ose të njohura direkt në kapital	14	0	(50,257)	50,257	0
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023		10,000	(50,257)	(76,408)	(116,665)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi/Humbja për periudhën kontabël				9,803	9,803
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		0	0	9,803	9,803
Transaksionet me aksionarët e njësisë ose të njohura direkt në kapital:					
Shpërndarje e rezultatit të periudhës			(76,408)	76,408	0
Totali i transaksioneve me aksionarët ose të njohura direkt në kapital	14	0	(76,408)	76,408	0
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024		10,000	(126,665)	9,803	(106,862)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

		2024	2023
Vlerat janë në mijë lekë. [000 lekë]	Shënime		
Fluksi i Mjeteve Monetare që lidhet me aktivitetin e shfrytëzimit			
Fitimi (Humbja) e vitit		9,803	(76,408)
Rregullime për:			
(Fitimet) Humbjet nga ndryshimet në kurset e këmbimit (neto)	25,26	(8,476)	1,164
Shpenzime interesi	26	56,056	57,797
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23,6,7	155,144	162,960
Te ardhura nga grandet	25,15	(70,165)	(44,325)
Te ardhura nga rimarrja e provizioneve	25,17	(1,598)	(2,212)
Te ardhura nga interesat	25	(10,077)	0
Humbje nga zhvleresimi i aktiveve afatgjata	6	0	1,166
		130,686	100,143
Rënie (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	11,25	31,551	(5,694)
Rënie (rritje) në inventarë	9,6,15,25	(6,891)	(7,614)
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	19	(39,052)	7,410
Fluksi neto që rezulton nga veprimtaritë e shfrytëzimit		116,295	94,245
Fluksi i Mjeteve Monetare që lidhet me aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	6,25	(84,638)	(119,080)
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	7,25	(1,226)	(3,239)
Interes i arketuar	26,8	10,077	0
Fluksi neto që rezulton nga veprimtaritë e investimit		(75,787)	(122,320)
Fluksi i Mjeteve Monetare që lidhet me aktivitetin e financimit			
Grande të arketuara	15,25	141,829	54,149
Interesi i paguar	18,25	(5,478)	(1,256)
Pagesa e huave	18	(32,598)	(11,670)
Fluksi neto që rezulton nga veprimtaritë e financimit		103,753	41,223
Fluksi neto që rezulton nga veprimtaria gjatë vitit		144,261	13,148
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar	12,25,26	367,115	355,490
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor	12	511,375	368,638

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

I. Njësia raportuese

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korrë SH.A është një njesi e regjistruar me numër unik M2443100IN dhe organizohet në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Selia e shoqërisë është në adresën Rajoni I, Blloku I Ri, Rr. "Boris Plumbi", Nr. 20, 7002, Korrë.

Shoqëria kryen veprimtaritë kryesore fushën e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve, mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe /ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të urjave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre.

Kapitali i nënshkruar i saj është 10,000,000 lekë dhe zotërohet nga aksionarë si vijon.

Zotërvuesi i aksioneve	Numri në copë	Vlera në lekë	Përqindja e zotërimit
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	51,000	5,100,000	51%
Bashkia Korrë	28,293	2,829,300	28.29%
Bashkia Maliq	8,674	867,400	8.67%
Bashkia Devoll	7,762	776,200	7.76%
Bashkia Kolonjë	3,638	363,800	3.64%
Bashkia Pustec	633	63,300	0.63%
Shuma	100,000	10,000,000	100%

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, i cili vepron pa kufizime të kompetencave dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.

Këshilli mbikqyrës është i përbërë nga shtatë persona dhe paraqiten në vijim.

Z.	Jetlir Gjergji	Kryetar
Znj.	Albina Xhyheri	Anëtar
Znj.	Florinda Buzhiqi	Anëtar
Znj.	Besa Spaho	Anëtar
Znj.	Aida Çela	Anëtar
Znj.	Erikselda Avdo	Anëtar
Z.	Bashkim Hazisllari	Anëtar

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit 2024 ishte 248 punonjës (2023: 268 punonjës).

Në kuadrin e politikës kombëtare të riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, shoqëria absorboi shoqëritë ekzistuese të ujësjellës kanalizimeve të qarkut Korrë duke përfshirë bashkitë Korrë, Devoll, Maliq, Kolonjë dhe Pustec. Data e transferimit të aktivitetit ishte data 1.11.2022 dhe nga kjo datë, të gjitha veprimtaritë, aktivet dhe detyrimet që realizoheshin nga shoqëritë ekzistuese u transferuar në favor të shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.a. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare Individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe adaptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK), si dhe në përputhje me ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në Shqipëri.

Për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023, Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri (SKK).

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë pasqyrat e para, të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të dhe data e kalimit sipas SNRF-ve është data 1 janar 2023. SNRF I kërkon dhënie informacionesh shpjeguese të detajuara për efektin e tranzicionit nga SKK-të në SNRF-të.

2.b. Baza e matjeve

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.c. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.d. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lekë"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

2.e. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë të raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3. Burimet për vlerësimin e pasigurisë

3.a. Provizione

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

3.b. Vlerësimi i rrezikut të kredisë

Vlerësimi i modelit të biznesit

Humbjet e pritshme të kredisë maten si një provizion i barabartë me humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumentet financiare. Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

Gjatë kalimit në SNRF 9, kompania identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale" me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk jepet për çmimin ose rrezikun e vlerës së drejtë;
- Deri më tani nuk ka pasur asnjë shitje të një aktivi financiar. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të rrezikut të kredisë nga pala tjetër, që rezulton nga shkeljet e kritereve të brendshme të rrezikut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me modelin "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale". Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore. Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e Arkëtueshme konsiderohet të jetë "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale".

3.c. Matja e vlerës së drejtë

Nuk ka politika kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të rëndësishme të adoptuara nga Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe pasivet financiare dhe jo-financiare. Supozimet në përcaktimin e vlerës së drejtë, kur janë të aplikueshme, prezantohen në shënimin përkatës.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra, përafrohet me vlerën kontabël kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

4. Përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabël

4.a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 ishin si më poshtë:

Monedha	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
LEKË për 1 EUR	98.15	103.88
LEKË për 1 USD	94.26	93.94

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.5 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim.

4.b. Instrumentet Financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera.

4.b.1. Njohja fillestare.

Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivët financiarë të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit. Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

4.b. Instrumentet Financiare (vazhdim)

4.b.2. Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese.

Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.b.3. Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.

Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

4.b.4. Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare.

Kur modeli i biznesit është mbajtur e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

4.b. Instrumentet Financiare (vazhdim)

4.b.5. Aktivet financiare – pakësimi i vlerës.

Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, pa aftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të zhvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

4.b.6. Aktivet financiare - çregjistrimi.

Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

4.b.7. Detyrimet financiare – kategorite e matjes.

Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

4.b.8. Detyrimet financiare – çregjistrimi.

Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

4.b.9. Kompensimi i instrumenteve financiare.

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të pa aftësisë së pagesës ose falimentimit.

4.b Instrumentet Financiare (vazhdim)

4.b.10. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4.b.11. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4.b.12. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

4.b.13. Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

4.c. Inventari

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përfshin shpenzimet e njohura gjatë blerjes së inventarit, prodhimit ose koston së tjetërsimit dhe kostove të tjera shtesë të njohura për ruajtjen dhe sjelljen në pozicionin ekzistues të inventarit. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe prodhimit në proces koston përfshijnë një marzh të kostove shtesë prodhuese, bazuar në operimin me kapacitet normal. Vlera neto e realizueshme është ekuivalente me diferencën e cmimit të shitjes së parashikuar, në rastin e një veprimtarie normale të biznesit me koston totale të parashikuara dhe shpenzimet e shitjes.

4.d. Aktivet afatgjata materiale

Janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë, përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me transformimin e aktivitetit në kushte pune për qëllimin e tij të caktuar si dhe kostot e montimit dhe largimit të aktivitetit dhe kthimin e zonës ku ka qenë vendosur aktivi në gjendjen e mëparshme. Çdo blerje programesh kompjuterike që është pjesë e pandashme e veprimtarisë së pajisjes është kapitalizuar si pjesë e kësaj pajisjeje.

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të AAM, njihet në vlerën e mbetur të AAM, vetëm nëse është e mundshme që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me këtë pjesë të zëvendësuar do të rrjedhin në Shoqëri si dhe nqs kostoja e saj mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Kostot ditore të mirëmbajtjes dhe të tjera të lidhura me AAM, do të njihen në shpenzimet e periudhës përkatëse që ato ndodhin.

Kostoja e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të njësive jo të rëndësishme të AAM regjistrohet si shpenzim mirëmbajtjeje në periudhën kur ndodh. Rinovimet dhe përmirësimet kapitalizohen. Kur kryhet shitja, nxjerrja jashtë përdorimit ose zëvendësimi i njëpjesë të AAM, kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar përkatës i zërit të nxjerrë jashtë përdorimit ose pjesës së zëvendësuar eliminohen nga llogaritë. Fitimi ose humbja që mund të rezultojë regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave.

Ndërtimi në proces përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjata materiale ende të papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende të papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ose paraardhëse financiare. Pas përfundimit, këto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proces, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjata materiale. Amortizimi vjetor paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Kosto e aktiveve shpërndahet përgjatë jetës së dobishme nëpërmjet amortizimit. Përcaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë e industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore. Ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

4.d. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Amortizimi

Normat e amortizimit të përdorura për periodhat 2024 dhe 2023.

EMËRTIMI I AKTIVEVE AFATGJATA	Normat e Amortizimit 2024	Normat e Amortizimit 2023
Ndërtesa	5%	5%
Ndërtime dhe instalime të përgjithshme/Impianti Fotovoltaik	5%	5%
Instalime specifike dhe komplekse Ujësjellës	1%	1%
Instalime specifike dhe komplekse Kanalizime	0,8%	0,8%
Matësat elektronik/mekanik	5%	5%
Makineri dhe pajisje pune	20%	20%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilje orendi	20%	20%
Mjete kompjuterike	25%	25%
Aktive Afatgjata jo materiale	15%	15%

4.e. Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë liqensat dhe të drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja

Liqensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

4.f. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë).

Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.g. Aktive investuese

Aktivi investues është aktiv i mbajtur për t'u dhënë me qira dhe/ose rivlerësim i kapitalit (përfshirë aktivet në ndërtim për qëllime të tilla), fillimisht maten me kosto, përfshirë kostot e transaksionit. Ato fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë transferohen në Shoqëri pavarësisht nëse titulli është transferuar apo jo. Fillimisht maten me kosto. Pas periudhës së njohjes, aktivet e investimit maten me modelin e koston. Zhvlerësimi i këtyre aktiveve të investimit llogaritet bazuar në vlerën e tyre të mbetur. Aktivet e investimeve të mbajtura nga një qiramarrës si një aktiv i përdorimit të drejtë maten fillimisht me koston në përputhje me SNRF 16.

4.h. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë të rëndësishme.

4.i. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë fluksi bruto i përfitimeve ekonomike gjatë periudhës aktuale dhe normale të aktivitetit të një njësie ekonomike kur ato flukse rezultojnë në rritje në kapital, përveç rritjeve të kontributeve nga pjesëmarrësit e kapitalit. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të konsideruar dhe pranuar si të arkëtueshme për shitjen e mallrave dhe shërbimeve gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së kompanisë. Të ardhurat janë të njohura neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet, rimbursimet dhe zbritjet.

Shoqëria i njeh të ardhurat në bazë të faturave të lëshuara, kur shumat e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që njësisia do të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike. Shumat e të ardhurave nuk mund të konsiderohen e matshme me besueshmëri, derisa të gjithë detyrimet e kushtëzuara që kanë të bëjnë me shitjen të jenë zgjidhur. Shoqëria bazon vlerësimet e saj mbi rezultatet historike, duke marrë parasysh llojin e konsumatorit, llojin e transaksionit dhe specifikat e çdo marrëveshjeje.

(a) Furnizimi i ujit të pijshëm dhe largimi i ujrave të ndotura

Të ardhurat nga shitja e furnizimeve përbëjnë vlerën e faturuar të sasisë së ujit të furnizuar dhe të larguar. Faturimet e ujit bëhen në baza mujore dhe llogariten sipas raportimit të matësive të instaluar.

(b) Të ardhura të tjera

Të ardhurat mbi shërbimet e ofruara klientëve si p.sh. Lidhje e re, ndryshimi i emrit në kontratë, verifikimi i matësit, etj. janë të njohura kur shërbimi ofrohet. Këto të ardhura, së bashku me të ardhurat nga kamatëvonesat për pagesat me vonesë, janë të përfshira në të ardhura të veprimtarisë.

(c) Të ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshëm mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përllogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

4.j. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.k. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.l. Aktivet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.m. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.n. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Riklasifikimet kryhen për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

4.o. Zbatimi i standardeve të rinj dhe të rishikuar

Në këtë shënim përfshihen ndryshime që kanë një ndikim të rëndësishëm në Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nevojiten sqarime të hollësishme. Për vitin 2024, nuk ka asnjë për t'u paraqitur, por siç kërkohet nga SNK 8, një njësi ekonomike të paraqesë informacion të detajuar mbi standardet që janë zbatuar për herë të parë në periudhën aktuale si dhe mbi standardet e lëshuara, por që ende nuk janë në fuqi dhe se ato do të zbatohen në të ardhmen.

4.o.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Përgatitja e Pasqyrave Financiare, në të gjitha aspektet materiale, është bërë në përputhje me Statndartet Ndërkombëtre të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të cilat janë lëshuar nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit (BSNK) dhe shpallur për zbatim nga Ministri i Financave dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2024 dhe që nuk kanë ndonjë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- SNK 1 – “Paraqitja e pasqyrave financiare”, klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata, data efektive 1 Janar 2024,
- SNRF 7 – “Instrumentat financiarë”, dhenie informacionesh, data efektive 1 Janar 2024
- SNRF 16 – “Qirata”, data efektive 1 Janar 2024;
- SNK 7 – “Pasqyra e fluksit monetar”

4.o.2. Standarde dhe interpretime të reja por që ende nuk janë efektive:

- SNK 21 “Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit”, monedhat e pakëmbyeshme, data efektive 1 Janar 2025
- SNRF 9 dhe SNRF 7, data efektive 1 janar 2026
- SNRF 18, data efektive 1 janar 2027
- SNRF 189 data efektive 1 janar 2027

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga njësi ekonomike. Menaxhimi parashikon që të gjitha deklaratimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë duke filluar nga ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet e pa miratuara në vitin aktual nuk janë përfshirë në shënimet shpjeguese pasi ato nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde dhe ndryshime të reja, por ende jo në fuqi, të Standardeve ekzistuese, si dhe Interpretimeve janë publikuar nga IASB ose IFRIC. Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime të Standardeve ekzistuese nuk është miratuar herët nga Njësia dhe nuk është lëshuar asnjë Interpretim që është i zbatueshëm dhe që duhet të merret në konsideratë nga Njësia në asnjërinë nga datat e këtij raportimi.

5. Raportimi për herë të parë sipas SNRF-ve

Këto pasqyra financiare, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, janë të parat të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të. Këto pasqyra përfshijnë edhe të dhënat për periudhën krahasuese që është viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023. Në këto kushte, data e kalimit sipas SNRF-ve është përcaktuar data 1 janar 2023, si data e fillimit të periudhës më të hershme që përfshihet në pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve.

Më parë shoqëria ka përgatitur dhe paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), prej këtej, SKK-të përfaqësojnë kuadrin e mëparshëm referues të përdorur për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Periudha më e fundit për të cilën shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare në përputhje me kuadrin e mëparshëm, është viti që mbyllet në datën 31 dhjetor 2023, datë e cila përfaqëson fundin e periudhës më të fundit, të paraqitur në pasqyrat financiare më të fundit, sipas kuadrit të mëparshëm.

Për përgatitjen e pasqyrave të para financiare në përputhje me SNRF-të shoqëria ka përdorur versionin e SNRF-ve të aplikueshëm në datën 31 dhjetor 2024, ndërsa për informacionet krahasuese që përfshihen në këton pasqyra ka përdorur versionet e aplikueshme në ato data, pa aplikime të hershme.

Shoqëria ka ripërgatitur pasqyrën e pozicionit financiar në datën 1 janar 2023, në përputhje me SNRF-të. Ripërgatitja rezultoi me ndryshime për shkak të aplikimit të SNRF-ve, por edhe për shkak të rregullimit të kryer për një gabim kontabël, përfshi disa riklasifikime të nevojshme që nevojiten për qëllime krahasueshmërie me periudhën aktuale. Për të shpjeguar ndryshimet është përgatitur pasqyra e posaçme rakorduese që paraqitet në shënimin 5.a të këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria ka ripërgatitur pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2023 në përputhje me SNRF-të. Asnjë ndryshim nuk rezultoi nga ripërgatitja e pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2023.

Shoqëria ka ripërgatitur pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023, në përputhje me SNRF-të. Asnjë ndryshim nuk rezultoi nga ripërgatitja e pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023.

Gjithashtu, shoqëria ka ripërgatitur pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2023, në përputhje me SNRF-të, e cila rezultoi me disa ndryshime që ndikojnë në fluksin monetar neto, si pasojë e kalimit nga SKK-të në SNRF-të. Gjithashtu ripërgatitja përfshin edhe disa riklasifikime që nevojiten për qëllime krahasueshmërie me periudhën aktuale, por pa ndikim në fluksin monetar neto. Për këtë është përgatitur pasqyra e posaçme që rakordon ndryshimet e ripërgatitjes, e cila paraqitet në shënimin 5.b të këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

5. Raportimi për herë të parë sipas SNRF-ve (vazhdim)

5.a. Rakordimi i pozicionit financiar në datën e kalimit sipas SNRF-ve

Pasqyra në vijim jep sqarime mbi ndryshimet në aktivet dhe detyrimet që rezultuan nga ripërgatitja e pasqyrës së pozicionit financiar në datën 1 janar 2023 duke e rakorduar vlerën e ndryshimeve të tyre me ndryshimin në kapitalin neto.

<i>Vlerat janë në mijë lekë. [000 lekë]</i>	<i>Shënime</i>	<i>1 janar 2023 SKK</i>	<i>ndryshimet</i>	<i>1 janar 2023 SNRF</i>
AKTIVET				
Aktivet afatgjata materiale	5.a.2	8,341,831	(39,859)	8,301,972
Aktivet afatgjata jo materiale		20,235	0	20,235
Aktivet afatgjata financiare	5.a.1-3	119,263	48,737	168,000
Aktivet Afatgjata		8,481,329	8,878	8,490,207
Inventarët		115,518	0	115,518
Kapital i nënshkruar i papaguar		4,900	0	4,900
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		411,938	0	411,938
Mjetet monetare	5.a.1-1	528,092	(168,000)	360,092
Aktivet Afatshkurtra		1,060,449	(168,000)	892,449
Aktivet Total		9,541,778	(159,122)	9,382,656
DETYRIMET				
Të ardhura të shtyra	5.a.1-3	2,858,094	(105,475)	2,752,619
Të tjera kontribute	5.a.2	1,136,568	(22,229)	1,114,339
Provizione		2,175	0	2,175
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		5,098,181	0	5,098,181
Detyrimet Afatgjata		9,095,018	(127,704)	8,967,314
Të ardhura të shtyra	5.a.1-2	13,788	(13,788)	0
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme		214,100	0	214,100
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		241,499	0	241,499
Detyrimet Afatshkurtra		469,387	(13,788)	455,599
Total Detyrimet		9,564,405	(141,492)	9,422,913
Total Aktivet pakësuar me Detyrimet		(22,627)	(17,630)	(40,257)
Kapitali i Nënshkruar		10,000	0	10,000
Fitimi (Humbja) e vitit	5.a.2	(32,627)	(17,630)	(50,257)
Total fondet e veta dhe kapitali		(22,627)	(17,630)	(40,257)

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

5. Raportimi për herë të parë sipas SNRF-ve (vazhdim)

5.a. Rakordimi i pozicionit financiar në datën e kalimit sipas SNRF-ve (vazhdim)

5.a.1. Ndryshimet nga kalimi sipas SNRF-ve

5.a.1-1. Riklasifikimi i depozitës bankare me afat

Shoqëria është palë në kontratën për depozitë bankare me bankën Credins, me afat maturimi më 17.2.2029, për vlerën 168,000,000 lekë, me kushte të qarta të thyerjes dhe me efekte materiale. Kjo kontratë ishte paraqitur në zërin "Mjetet monetare" por u riklasifikua dhe u kalua në zërin "Aktive afatgjata financiare".

5.a.1-2. Subvencionet afatshkurtra

Subvencione për investime nga SSË dhe Eaterenergy për vlerën 13,787,846 lekë ishin paraqitur si "Të ardhura të shtyra" afatshkurtra, ndërsa në fakt janë financime për krijimin e aktiveve që paraqiten në aktivet afatgjata. Këto subvencione janë trajtuar rregullisht duke u kaluar periodikisht në të ardhura, në përputhje me amortizimin e aktiveve që ato kanë financuar. Riklasifikohen dhe paraqiten në zërin "Të ardhura të shtyra" afatgjata.

5.a.1-3. Gërgjistrimi i aktivitetit financiar

Mardhënia me aksionarin Bashkia Korçë për shumën 119,262,809 lekë. Kjo mardhënie bazohet në angazhimin për mbështetje financiare nga ana e Bashkisë Korçë, njohur si aktiv që prej periudhës 2010.

Ky element nuk plotëson kriteret për tu njohur si aktiv nga kuadri i SNRF-ve pasi nuk ekzistojnë mundësi reale që aktivi të sjellë përfitime ekonomike. Sikurse shprehemi, aktivi është njohur mbi bazën e një marrëveshje ndërpalëse në vitin 2010 por bashkia nuk ka kryer asnjë financim. Po ashtu, marrëveshja nuk ka kushte detyruese e për pasojë *nuk ka përmbajtje*. Në këto pozita, shoqëria vendosi që të gërgjistrojë aktivin dhe efekti të mbulohet nga gërgjistrimi i llogarisë reflektuese që është njohur së bashku me aktivin, e cila është paraqitur në detyrimet afatgjata "Të ardhura të shyra" për vlerën 119,262,809 lekë.

Në tërësi, përfshi riklasifikimin e depozitës bankare, riklasifikimin e subvencioneve dhe gërgjistrimin e kontratës me bashkinë rezulton ndryshimet si në vijim.

Vlerat janë në mijë lekë, [000 lekë]	Aktive afatgjata financiare	Të ardhura të shtyra afatgjata	Mjetet monetare	Të ardhura të shtyra afatshkurtra
Pozicioni sipas SKK-ve	119,263	2,858,094	528,092	13,788
Efekti nga gërgjistrimi i kontratës me bashkinë	-119,263	-119,263	0	0
Efekti nga riklasifikimi i kontratës së depozitës bankare	168,000	0	-168,000	0
Efekti nga riklasifikimi i subvencioneve afatshkurtra	0	13,788	0	-13,788
Efekti neto i ndryshimeve	48,737	-105,475	-168,000	-13,788
Pozicioni sipas SNRF-ve	168,000	2,752,619	360,092	0

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

5. Raportimi për herë të parë sipas SNRF-ve (vazhdim)

5.a. Rakordimi i pozicionit financiar në datën e kalimit sipas SNRF-ve (vazhdim)

5.a.2. Rregullimi i gabimit kontabël

